



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:139909

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428136

Rev.nr.85/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zenel Leku, kryetar i kolegjit, Muhamet Rexha dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M.F.V., F.A.V., dhe R.F.V., që të tre nga H. E., të cilët me autorizim i përfaqëson Emrush Kastrati, avokat nga Prishtina, kundër të paditurve N.J.V., B.A.V., S.M.V, S.H. V., dhe S. H.V., të gjithë nga H.E., të cilët me autorizim i përfaqëson Visar Musa, avokat nga Ferizaj, në çështjen kontestimore pengim posedim, duke vendosur sipas revizionit të paraqitur nga i autorizuari i paditësve, i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5909/22, të datës 05.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Hedhet poshtë i palejuar revizioni i të autorizuarit të paditësve M.F.V., F. A.V.,dhe R. F.V., nga H. E., i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5909/22, të datës 05.10.2023.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin C.nr.2021:232038, të datës 16.08.2022, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve M.F. V., F.A.V., dhe R.F.V., që të tre nga H.E., si të pa bazuar, me të cilën kanë kërkuar që të

vërtetohet se të paditurit N.J.V., B.A.V., S.M.V., S.H.V., dhe S.H.V., të gjithë nga H.E., më datë 10.06.2019, rreth orës 13:30 kanë angazhuar kompaninë ‘R’- F., dhe kanë hedhur zhavorr në tri vende dhe atë: në ngastrën kadastrale nr...-, dy grumbuj të një zhavorrit me njësi prej 14.85 m<sup>3</sup> dhe në vendin tjetër në sasi prej 24.50 m<sup>3</sup>, që pronari i kësaj ngastre është e paditura N.V., kurse në ngastrën kadastrale nr...-, është hedhur një sasi e zhavorrit prej 5,09 m<sup>3</sup> pronar i së cilës është F.V., dhe në ngastrën kadastrale nr....-, është hedhur sasia e zhavorrit prej 5.23 m<sup>3</sup>, pronar i së cilës është i padituri H.V, të gjitha ngastrat në ZK-Neqavce, ashtu që e kanë bërë të pamundur kalimin në rrugë çoftë në këmbë apo me mjete tjera transportuese dhe mjete të tjera të udhëtarëve, me çka i kanë penguar paditësit në shfrytëzimin e rrugës së cekur për të shkuar në shtëpinë e tyre e cila është e ndërtuar ngastrën nr...-,- Neqavce, H.E., si e pa bazuar. Në pikën II të dispozitivit janë detyruar paditësit që të paditurve t’ua paguajnë shpenzimet procedurale në shumë prej 3,786 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5909/22 të datës 05.10.2023, është refuzuar e pabazuar ankesa e paditësve M.F.V., F.A.V., dhe R. F.V., që të tre nga H.E., ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.2021:232038, i datës 16.08.2022.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësve, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranojë revizionin e paditësve si të bazuar, të aprovoj kërkesëpadinë e paditësve ose të prishë aktvendimet e gjykatave të instancave më të ulëta dhe të kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

I autorizuari i të paditurve nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditësve.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 218, 221 dhe 230, gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditësve është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit përmes të autorizuarit të tyre, më datë 27.06.2019 kanë parashtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurve, lidhur me çështjen pengim posedimin me kërkesë që të aprovet në tërësi si e bazuar kërkesëpadi e tyre.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar kërkesën e paditësve e cila ka të bëjë me çështjen e pengimit të posedimit, vlerëson se në kontestet e tilla-çështjen e pengimit të posedimit revizioni është i palejueshëm.

Me dispozitën e nenit 228 paragrafi 1, të LPK-së, përcaktohet se: *“Palët mund të paraqesin revizion kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallë së dytë”*, ndërsa në paragrafin 2 të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Nuk lejohet revizioni kundër aktvendimeve nga paragrafi 1 i këtij neni në konteste në të cilat nuk do të ishte i lejuar revizioni”*. Përveç kësaj, me dispozitat e nenit 481 paragrafi 4, përcaktohet se: *“Kundër aktvendimeve të dhëna në kontestet për shkak të pengimit të posedimit revizioni nuk është i lejuar”*.

Duke marrë parasysh këto dispozita, rezulton se revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5909/22 të datës 05.10.2023, pasi që me këtë aktvendim është vërtetuar vendimi i shkallës së parë e që për objekt shqyrtimi ka qenë çështja e pengimit të posedimit dhe nën rrethanat që çështja është trajtuar si pengim posedim nuk lejohet revizioni, pasi që në konteste të tilla me nenin 481.4 të LPK-së, shprehimisht është përcaktuar se revizioni nuk lejohet.

Meqenëse gjykata e shkallë së parë nuk e ka hedhë revizionin e paditësve ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 218 të LPK-së, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës sipas dispozitës së nenit 221 të LPK-së, vendosi që ta hedhë poshtë revizionin si të palejueshëm.

Sipas arsyeve të theksuara më lart, e në pajtim me dispozitën e nenit 221 dhe 481 paragrafi 4 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.85/2024, më datë 07.03.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari  
Zenel Leku